



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.82/2016

Prishtinë, më 13.12.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha – Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Rustem Berisha, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Mungoi: Glauk Konjufca, zëvendëskryetar i parë dhe Sasha Milosavljeviq, zëvendëskryetar i dytë.

I ftuar: Hanefi Muharremi, zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës - MI.

Pjesëmarrës të tjerë: Habib Hasani - MI, Fjolla Uka – KDI, Dardan Abazi – INDEP, Shefki Kastrati – NDI dhe Etleva Malushaj – LVV.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 6.12.2016;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-132 për Automjete;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Fatmir Rexhepi propozoi që të shtohet edhe një pikë në rendin e ditës: “Shqyrtimi i Raportit me Amendamente i Projektligjit nr.05/L-089 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme në Kosovë;” pasi që grupi i punës e ka përfunduar punën e vet.

Rendi i ditës u miratua me propozim të z. Rexhepi, që të shtohet pika e katërt e re e rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit me Amendamente i Projektligjit nr.05/L-089 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme në Kosovë.

2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 6.12.2016

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 6.12.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-132 për Automjete

Kryetari tha se sot e kemi në shqyrtim në parim projektligjin për Automjete, që është sponsorizuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe me këtë projektligj po mbyllet pakoja e projektligjeve që kanë bëjnë më komunikacionin rrugor. Në emër të ministrisë kemi zëvendës ministrin, z. Hanefi Muharremi, për ta arsyetuar para Komisionit projektligjin, të cilit ia dha fjalën.

Hanefi Muharremi, zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës, në emër të Ministrisë së Infrastrukturës, si bartëse e këtij projekti legjislativ shkurtimisht të paraqiti qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e projektligjit për Automjete. Bazuar në nevojën për ngritjen institucionale me qëllim të ngritjes së sigurisë në komunikacionin rrugor dhe kontrollit të cilësisë së shërbimeve nga ana e institucionit të autorizuar nga Ministria e ngarkuar për transport është bërë ndryshimi i këtij ligji. Më hollësisht bëhet përcaktimi i kushteve bazë të pajisjeve dhe instalimeve të cilat duhet t’i ketë mjeti, dimensionin, masa më e madhe e lejuar dhe ngarkesa boshtore e mjetit, si edhe kushtet të cilat duhet t’i plotësojë mjeti në komunikacion, kushtet për importim, miratimi tipit të mjetit, pjesës përbërëse, njësisë se pavarur teknike, kontrollimi teknik i automjeteve, regjistrimi i automjeteve, si dhe çështje të tjera lidhur me to. Më këtë ligj kemi mundësuar harmonizimin e dispozitave me rregullat dhe Direktivat e Bashkimit Evropian, për çështjet që kanë të bëjnë me kushtet të cilat duhet t’i plotësojnë mjetet me rastin e importit, regjistrimi i mjeteve dhe kushtet të cilat duhet t’i plotësojë mjetet me qëllim të mbrojtjes së ambientit, dhe të përmirësimit të sigurisë në komunikacionin rrugor. Qëllimi i ndryshimit të Ligjit nr. 02/L-70 dhe përgatitja e ligjit të ri për automjete ka të bëjë me mënjanimin e gabimeve teknike dhe harmonizimi me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian. Prandaj, duke u mbështetur në praktikat e vendeve të tjera është aprovuar propozimi për ndarjen e Ligjit nr. 02/L-70 Për siguri në komunikacionin rrugor në tri ligje: Ligji për Patentë shofer, Ligji për Rregullat e trafikut rrugor, dhe tani projektligji për Automjete. Ky projektligj është një ndër prioritetet e Qeverisë së Kosovës sepse ky akt ligjor rregullohet, mbrohet dhe zbatohet në dobinë dhe të mirën e interesit publik.

Kryetari tha se më këtë projektligj po shihet se janë rregulluar deri në detaje procedurat, miratimi, kushtet dhe kriteret për automjete më qëllim që të bëhet parandalimi i fatkeqësive që na kanë përcjellë deri më tani në komunikacionin rrugor. Andaj, është e nevojshëm sigurimi i cilësisë në aspektin teknik të automjetit në aspektin që duhet t'i plotësojnë kushtet nga subjektet që merren më kontrollin teknik. Po ashtu, çështjet që duhet të trajtohen më qartë në projektligj janë subjektet që merren më kontrollin teknik të automjetet dhe çështja e homologimit në mënyrë që të lejohet konkurrenca e lirë edhe kjo çështje duhet të qartësohet deri në detaje, dhe të kemi një përkufizim më të qartë të homologimit.

Blerim Grainca tha se projektligji për automjete është i rëndësishëm së veçantë, pasi që po definohen rregulla të veçanta të sigurisë në komunikacion, me theks të veçantë po punohet që të këtë efekte më të mira në aspektin e sigurisë, por edhe në kualitetin e jetës, sepse për ditë po kemi një ambient jo kualitativ për shkak të veturave të vjetra. Ndërsa, kur flasim për anën teknike për automjete duhet të këtë një bashkëpunim më të mirë në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, veçanërisht pjesa te kontrolli teknik që janë të licencuar nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës në mënyrë që nga kontrollimi teknik që iu behet automjeteve të evitohen rreziqet që mund të paraqiten në komunikacionin rrugor, dhe propozoj që të futet një nen që e rregullon edhe e sanksionon jo vetëm kontrollin teknik, por edhe agjentët të cilët ofrojnë shërbime të tilla, sepse mendoj se është vepër penale sjellja e tillë, siç është tani sepse kjo po e rrezikon jetën e qytetarëve në komunikacionin. Lidhur me çështjen e homologimit për automjete kërkoi nga përfaqësuesit e ministrisë që të sjellin një informatë në mes të dy leximeve, sepse kemi vetëm një operator dhe është bërë temë publike ky monopol, si dhe të sanksionohen më mirë nenet 32 dhe 33 i Ligjit dhe ky treg të liberalizohet dhe të kemi konkurrencë së lirë lidhur me homologimin e automjeteve. Përndryshe e përkrahu në parim.

Fatmir Rexhepi vlerësoi se është bërë një punë e mirë që është bërë ndarje pakos së projektligjeve në disa ligje për komunikacionin rrugor, pasi që është bërë ndarja e përgjegjësive në mes institucioneve, besoj që do të këtë zbatim më të mirë të rregullave të komunikacionit rrugor. Lidhur me Projektligjin për Automjete, theksoi se gjatë shqyrtimit në Komision do ta bëjmë më komplementar në caktimin e kriterëve strikte pasi që deri më tani shkalla rritjes së aksidentëve ka qenë e madhe dhe më anë të përcaktimit të kushteve dhe kriterëve, do të krijojmë parakushte për parandalimin e aksidentëve. Ndërsa, lidhur me çështjen e homologimit, tha se pajtohem se duhet të specifikohet më mirë dhe qartë që të mos kemi monopol, siç e kemi deri tash. Lidhur me kriteret dhe përgjegjësitë ka shumë punë sepse është një numër i madh i propozimeve që duhet të shikohet për dënimet për subjektet dhe individët sepse ka laramani të madhe dhe, kjo do të rregullohet edhe në debatin parlamentar në Kuvend edhe në Komision. Ai tha e përkrahu në parim projektligjin.

Raif Qela tha se me këtë projektligj plotësohet pjesa e mbetur e ligjeve nga pakoja e ligjeve për sigurinë e trafikut rrugor dhe aq sa shihet kontribuon në mënyrë që kjo fushë të rregullohet në tërësi. Në përgjithësi Ligji duket se është punuar mirë meqenëse ka vend për plotësime, plotësime që unë mendoj se duhet t'i këtë Ligji dhe se duhet të precizohet vjetërsia e automjeteve të importuara, problem i cili na shfaqet sidomos edhe pasi që është pasqyruar edhe në Raportin e Progresit për shkak të ndotjes së ambientit nga makinat e vjetra. Nuk kemi nevojë që të vazhdojmë më tutje të importojmë bërllok të Evropës. Është e nevojshme që kjo çështje të rregullohet edhe me Ligj, e jo me akte nënligjore. Një e metë tjetër e këtij projektligji, si dhe projekt-ligjeve të

tjera nga kjo ministri, është se, edhe ky projekt- ligj vuan prej gabimeve të shumta teknike drejtshkrimore, po thajse në nivelin që kanë qenë po ashtu edhe dy projekt-ligje të tjera. Ligji për Trafikun Rrugor edhe Ligji për Patentë shoferi. Prandaj, propozoj që për shkak të moskujdesit të Ministrisë, sepse i ka sjellë në formën të cilën jemi marrë vesh që projekt-ligjet para se të sillen të bëhet një redaktim gjuhësor i tyre, kjo punë nuk është bërë sepse shihet që ka mungesë jo vetëm e të njohjes së gjuhës, por edhe gabime teknike që thjesht mund të shihen me një kujdes pak të shtuar, p.sh. vetëm në Nenin e parë janë diku dhjetë gabime mos përshtatje në vetë dhe mos përshtatje të tjera që nuk është dashtë t'i ketë një Ligj i cili nxirret prej institucioneve të Republikës së Kosovës. Prandaj, unë ju propozoj apo ju bëni si të doni, por unë ju propozoj që për shkak se nuk kanë qenë të kujdesshëm nuk i kanë përfillur sugjerimet e Kuvendit, që dokumentet kur t'i sjellin si projekt-ligje, t'i sjellin të përpunuara, të korrigjuara. Ne t'ia kthejmë mbrapshtë Qeverisë.

Besim Beqaj tha se kam pritur që më këtë projektligj ka më i fokusuar ligji, por sa po e shoh nuk është i tillë, veçanërisht për vjetërsinë e makinave. Tha që lidhur më fushën e komunikacionit rrugor i kemi dy probleme themelore që kanë të bëjnë më automjete, e para është importimi i automjeteve të vjetra, që është goxha i madh për nga numri dhe dyta është kontrollimi teknik sepse rrezik kemi nga edhe emetimi i gazrave dhe shpenzimi jocilësor i shpenzimit të karburanteve. Konsideroi që këto dy çështje mund të evitohen në mes të dy leximeve, duke e caktuar shkallën e importit të automjeteve dhe kontrollomini më i madh nga ministra në pikat e kontrollimeve teknike, në mënyrë që të kemi një kontroll më të saktë për ta parandaluar rrezikun që kemi pothuajse çdo ditë në komunikacionin rrugor dhe duhet të kemi penalizim në këtë drejtim. Dhe vetëm në këtë mënyrë rregullohet kjo fushë e jo vetëm ta bëjmë edhe një kapitull të ri të legjislacionit apo reformë ligjore sa për sy e faqe. Pra, duhet ta kemi të qartë sepse krejt thelbi i problemit është veturat e pasigurta në trafik dhe kjo bëhet për shkak të importit dhe për shkak të mos kontrollimit teknik.

Hanefi Muharremi, zëvendësministër i infrastrukturës, dha sqarime shtesë për shqetësimet që u ngritën, për kontrollimet teknike të automjeteve, tha që ministria ka nxjerrë një vendim ku Qendrat e Kontrollove Teknike, duhet të bëjnë kontrollimin në mënyrë të detajuar dhe në qoftë se ka defekte automjeti atëherë nuk i jepet verifikim së është gjendje të rregullt automjeti, ndërsa të rregullohet defekti i automjetit. Këto pika të kontrollove teknike monitorohen dhe nga inspektoret e ministrisë më anë të kamerave, pra incizohet. Po ashtu, ministria kohë pas kohë e bënë kontrollimin teknik të automjeteve më anë të kontrollove mobile që i ka, por kjo çështje është edhe kompetenca e Policisë që duhet t' i kontrollojnë automjetet. Për homologimin, tha se pas aprovimit të këtij ligji, nuk do të ketë monopol dhe do të krijohet konkurrenca e lirë, pasi që deri me tani, siç e dinë ka pasur një marrëveshje nga Qeveria e kaluar për vetëm më një operator, për këtë shërbim që përfundon në këtë vit dhe ndërprerja kontratës në mënyrë të njëanshëm mund të i shkaktonte probleme ligjore. Lidhur më importin e makinave të vjetra, tha që kjo çështje mund të rregullohet më një udhëzim administrativ apo vendim të qeverisë që të caktohet viti i vjetërsisë se prej cilit vit të prodhimit automjetet mund të importohen, por unë mendoj që secili automjet mund të këtë katalizatorin e vet dhe ky problem do të zgjidhet lehtë. Sa i përket të metave gjuhësore që janë, por do të eliminohen sepse e pranojmë që mund të këtë gabime.

Besim Beqaj, sa i përket kësaj që po thirrën në vendimet e qeverive të kaluara, tha se sa herë po ka probleme, tani kjo qeveri që është, e ka mandatin e plotë që ta ndryshojë çdo ligj, kështu që e ndryshoni.

Fatmir Rexhepi propozoi që vjetërsia e importit të automjeteve të caktohet më këtë Ligj dhe jo me ia lënë në vullnetin e qeverive përmes udhëzimeve administrative.

Pas debatit, Komisioni, më 7 (shtatë) vota Për dhe 1 (një) Kundër, nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet në parim Projektligji nr.05/L-132 për Automjete.

2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.05/L-132 për Automjete.

Komisioni vendosi që grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji, të jetë me këtë përbërje: Fatmir Rexhepi kryesues, Sala Berisha- Shala dhe Enver Hoti.

4. Shqyrtimi Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.05/L-089 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme në Kosovë.

Kryetari tha sa i përket kësaj pike, ia kaloi fjalën z. Fatmir Rexhepit, kryesues i grupit të punës që ta paraqesë raportin me amendamente të këtij projekt-ligji.

Fatmir Rexhepi tha më lejoni që në emër të grupit të punës t'i arsyetojë në parim amendamentet. Ne e kishim takimin tonë bashkë edhe me pjesëmarrjen e stafit të Qeverisë, ministrisë përkatëse, e kemi trajtuar projektligjin prej amendamentit të parë deri tek amendamenti i fundit. Kemi pasur për bazë me e ruajtur qëllimin e projektligjit që e ka në preambulën e vet. Pra, të kemi një konkurrencë sa i përket tregut të lirë, sa i përket importit të naftës. E dyta, ka qenë rekomandimet që i kemi pasur parasysh gjatë debatit në Kuvendin e Kosovës nga të gjitha grupet politike. Dhe e treta, ka qenë, po ashtu edhe një pjesë e rekomandimeve që kanë ardhur nga debatet e mëhershme që i kemi pasur me grupet e interesit. Pra, jemi munduar që t'i përfshijmë këto, t'i bëjmë amendamentet të cilat i keni para vetes. Po ashtu, kemi bërë shkurtime të disa afateve sa i përket përgjigjes së institucioneve, sepse kemi menduar që më këtë e luftuam burokracinë. Amendamentet janë votuar në mënyrë unanime nga grupi i punës, ndërsa harmonizimi në mes të amendamenteve, e ka kuptimin që në qoftë se e prishim një amendament do të prishim edhe tri a katër të tjera, kështu që, është mirë që këtë me pasur parasysh dhe konsideratë Komisioni, tani mundemi me shkuar amendament për amendament për votim.

Kryetari i propozoi për votim amendamentet si vijon:

Amendamenti 1

Neni 3, nënparagrafi 1.13. riformulohet.

Miratohet.

Amendamenti 2

Neni 4, nënparagrafi 1.6 fshihet.

Miratohet.

Raif Qela sipas shpjegimit të ekspertëve të ministrisë që të tria duhet të hiqen sepse nuk i përkasin fushës së departamentit dhe propozoj që amendamentet 2, 3 dhe 4 të fuzionohen me një amendament.

Komisioni nuk e përkrahu propozimin e z. Qela.

Amendamenti 3

Neni 4, nënparagrafi 1.8 fshihet.

Miratohet.

Amendamenti 4

Neni 4, nënparagrafi 1.9 fshihet.

Miratohet.

Amendamenti 5

Neni 5, paragrafi 6, ndryshohet.

Miratohet.

Amendamenti 6

Neni 6, në paragrafin 6, shkurtohet afati.

Miratohet.

Amendamenti 7

Neni 6, në paragrafin 11, shkurtohet afati.

Miratohet.

Amendamenti 8

Neni 7, në paragrafin 1, shkurtohet afati.

Miratohet.

Amendamenti 9

Neni 8, fshihet nënparagrafi 1.4 dhe referenca “1.4” në paragrafin 3, të këtij neni.

Miratohet.

Amendamenti 10

Neni 9, paragrafi 3, riformulohet.

Miratohet.

Amendamenti 11

Fatmir Rexhepi tha tanimë e kemi më të qartë verifikimin e cilësisë dhe e kemi shtuar kontrollin në tri pika, si dhe çdo biznes duhet të jetë i fiskalizuar.

Besim Beqaj tha se dy pika janë të rëndësishme në këtë Ligj, një është çështja e deponive të naftës dhe që janë thirrur në rezervat shtetërore që mendoj që janë gabim. Së pari nuk është ky ligji i cili i cakton rezervat shtetërore dhe e dyta nuk është korrekte të dilet dhe thuhet se kjo i bënë rezervat shtetërore, i thua kompanisë ti duhesh me i pas në rezervat e tua 10 mijë litra naftë dhe nuk bënë me i pas asnjëherë nën 10 mijë litra. Dhe e dyta, çështja e cilësisë, cilësia e naftës duhet të kontrollohet në pikat e shitjes, sepse ne s’kemi problem më cilësinë e derivateve të naftës në import. Pra, me amendament e kemi rregulluar që në tri pika të kemi kontroll të cilësisë.

Kryetari tha pasi që ne kemi ligj për rezervat shtetërore s’kemi nevojë ta kemi edhe në këtë ligj sepse s’mund të rrimë pa rezerva shtetërore dhe kërkoj sqarim lidhur më kontrollin e cilësisë dhe çështjen konformitetin e dokumentit.

Blerim Grainca sqaroi se janë tri forma të kontrollit të cilësisë, një që e bën Dogana, e dyta në deponi dhe e treta në pikën e karburantit. Shpenzimet i bartin subjektet, por nëse përsëri dëshiron më i bërë analizat Dogana, ajo vetë i bartë shpenzimet. Ndërsa, ne me amendament e kemi rregulluar dhe e kemi hequr analizën e konformitetit dhe e kemi caktuar që më qenë laboratorët e akredituam.

Raif Qela propozoj që amendamenti 11, duhet të këtë edhe një përmirësim më të mirë dhe më të qartë dhe e propozoj si vijon:

Neni 10, paragrafi 2, teksti “Verifikimi i cilësisë bëhet përmes testimeve laboratorike ku shpenzimet i bartë subjekti.” zëvendësohet me tekstin: “Verifikimi i cilësisë bëhet përmes testimeve laboratorike nga laboratorët e akredituar dhe të autorizuar nga Ministria dhe atë në pikat doganore, në deponi dhe në pikat e shitjes me shumicë dhe pakicë. Shpenzimet e testimeve laboratorike i bartë subjekti afarist”.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Qela.

Amendamenti 12

Neni 12, paragrafi 1, pas fjalisë “çrregullimet në treg” shtohet fjalia “në rast krize”.

Miratohet.

Amendamenti 13

Neni 14, paragrafi 1, fshihet.

Miratohet.

Amendamenti 14

Raif Qela tha se në grup punë janë ndryshuar vetëm shumat e dënimeve, ndërsa tha se mendoj se duhet të riformulohet në tërësi, që të jetë më i rrjedhshëm dhe më i qartë paragrafët 2 dhe 3, sepse është i pakuptimit, dhe e propozoj ndryshimin si vijon:

Neni 15, paragrafi 2, riformulohet si vijon:

2. Me gjobë në shumë prej 5.000 (pesë mijë) eurosh, për secilin produkt veç e veç, dënohet subjekti i cili ushtron pa leje veprimtarinë e shitjes me pakicë të produkteve të naftës ose të karburanteve të ripërtëritshme, kurse personi përgjegjës i personit juridik sipas këtij paragrafi dënohet me gjobë në vlerë prej 1000 (një mijë) eurosh, sipas nenit 5 të këtij ligji.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Qela.

Amendamenti 15

Neni 15, paragrafi 3, riformulohet.

Amendamenti u miratua nga Komisioni sipas propozimit të z. Qela.

Amendamenti 16

Neni 15, paragrafi 15, riformulohet.

Miratohet.

Kryetari paraqiti shqetësimin se afati i licencimit është mjaft i shpeshtë, pyeti grupin e punës së si e keni rregulluar?

Fatmir Rexhepi sqaroi se më ligj është e rregulluar afati i licencës të jetë 5 (pesë) vjet dhe kjo kemi menduar që është ne rregull dhe nuk e kemi ndryshuar.

Pas debatit Komisioni njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet raporti me amendamente i Projektligjit nr.05/L-089 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtëritshme në Kosovë, dhe procesohet për Komisionet e përhershme sipas procedurës.

Komisioni kërkon nga Komisionet e përhershme që ta trajtojnë me prioritet këtë raport me amendamente, në mënyrë që ta procedojmë për lexim të dytë para përfundimit të sesionit.

5. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoj në ora 12.00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa